




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12. paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 ( Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenit 36.2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seance e mbajtur më datën 31.10.2016, aprovon këtë:

## V E N D I M

**Për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm, parcelat në zonën kadastrale në fshatin Sllatinë, të cilat parcela gjenden nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit**

### Neni I

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë, MIRATON vendimin, që të shpall zona me interes të përgjithshëm për këto parcela, me nr. 1188-0, zona kadastrale Sllatinë, sipërfaqja 32237m<sup>2</sup>, parcela me nr. 1187-1 zona kadastrale Sllatinë, sipërfaqja 61934m<sup>2</sup>, parcela me nr. 1189-3 zona kadastrale Sllatinë, sipërfaqja 227314m<sup>2</sup>, parcela me nr. 1189-4 zona kadastrale Sllatinë sipërfaqja 139630m<sup>2</sup>.

### Neni II

Parcela kadastrale të sipërshënuara, që janë objekt i këtij vendimi, janë në pronësi të ndërmarrjes shoqërore të menaxhuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe kanë sipërfaqe të ndryshme.

### Neni III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

### Neni IV

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Agjencisë Kosovare të Privatizimit
2. Drejtorisë për Kadastër Pronë
3. Shërbimit të Kuvendit
4. MAPL
5. Arkivit

KRYESUES I KUVENDIT  
Naim Pira

